

KËRKESË
Nr. 609, datë 7.3.2019

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT
“GRAMOZ DEMIRI”

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë, duke u konfirmuar nga shërbimi postar, largimi i subjektit nga ajo adresë apo adresë jo e saktë.

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ, respektivisht për subjektin si më poshtë:

1. GRAMOZ DEMIRI

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR
NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA TIRANË
Elvisjon Salke

VENDIM
Nr. 994, datë 1.2.2019

I KOMSIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018 të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 2, datë 9.10.2018, të ISHMPU-së, Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit **“Gramoz Demiri”** protokolluar me nr. 5437, prot., datë 16.10.2018

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën 1, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masës administrative në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 2, datë 9.10.2019, në vlerën 1,500,000 lekë dhe pezullimin plotësisht të aktivitetit dhe rrëzimin e ankimit të subjektit ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj